

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË AKTIN NORMATIV NR.8, DATË 7.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR SUBVENCIONIMIN E PAGESËS SË QIRASË SË BANESËS PËR FAMILJET E MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E FATKEQËSISË NATYRORE, TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ndryshimi i aktit normativ propozohet me qëllim shtyrjen e afatit për përfitimin e subvencionimit të qirasë, sipas procedurës së përshpejtuar, për familjet, banesat e të cilëve, si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, janë shembur ose janë deklaruar si të pabanueshme me aktkonstatim nga Instituti i Ndërtimit.

Ky afat propozohet të zgjatet deri në momentin që familjeve të prekura t’u rindërtohet apo rikonstruktohet banesa e dëmtuar.

Akti normativ propozohet për shkak të nevojës që lind për të kapërcyer disa procedura, afate kohore dhe dokumente standard që kërkohen nga ligji nr.22/2018, “Për strehimin social”, dhe akteve nënligjorë në zbatim të tij, ndër të cilat më kryesoret: aplikimi në bashki, kalimi në komisionin e strehimit, vërtetim negativ që familja nuk disponon prone, kontrata e qirasë dhe vërtetim mbi të ardhurat familjare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky akt normativ nuk është parashikuar në planin analitik të projektakteve për vitin 2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij akti normativ është diktuar në kuadër të masave që po merr qeveria për t’u ardhur në ndihmë familjeve, banesat e të cilëve, si rezultat i

tërmetit të datës 26.11.2019, janë shembur ose janë deklaruar si të pabanueshme me aktkonstatim nga Instituti i Ndërtimit.

Subvencionimi i qirasë është një instrument financiar që i jep zgjidhje të shpejtë situatës së strehimit të familjeve që kanë ngelur të pastreha si rezultat i fatkeqësisë natyrore, deri në momentin që familjeve t'u rindërtohet apo rikonstruktohet banesa e tyre.

Ky akt normativ synon të shkurtojë procedurat, afatet kohore dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet përfituese si edhe bashkitë për të përfituar mbështetje buxhetore, duke shmangur disa parashikime të ligjit nr.22/2018 (nenet 35, 37, 39) deri në sigurimin e strehimit nëpërmjet programit të rindërtimit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Akti i propozuar për miratim është akt normativ me fuqinë e ligjit në bazë të nenit 101 të Kushtetutës, i cili përcakton se Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit. Ky akt normativ i referohet ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, për sa i takon subvencionimit të qirasë si një instrument financiar i parashikuar në këtë ligj, si edhe lidhur me kategorinë e familjeve që kanë ngelur të pastreha për shkak të fatkeqësive natyrore.

Miratimi i këtij akti normativ është diktuar në kuadër të përfundimit të afatit një vjeçar të aktit normativ nr.8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, si dhe në kushtet ku rindërtimi i banesave të dëmtuara nga tërmeti nuk ka përfunduar ende.

Në të njëjtën kohë, miratimi i këtij akti normativ është domosdoshmëri, nisur nga situata aktuale e shkaktuar nga COVID-19, e cila vështirëson sigurimin e dokumentacionit sipas ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 7 ndryshohet duke shtyrë afatin e përfitimit të subvencionimit të qirasë sipas këtij akti normativ, deri në momentin që familjeve u rindërtohet ose rikonstruktohet banesa, e cila, si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, është shembur ose është deklaruar si e pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij akti normativ janë njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ministria përgjegjëse për strehimin.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Akti normativ është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si ministria përgjegjëse për strehimin, bazuar në vendimin nr.503, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Për vitin 2021, në buxhetin e shtetit janë planifikuar rreth 1,5 miliardë lekë, për subvencionimin e qirasë për familjet e prekura nga tërmeti.

Ky akt normativ nuk parashikon shpenzime shtesë për burimet njerëzore pasi procedurat do të ndiqen nga strukturat/stafet ekzistuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.

KËSHILLI I MINISTRAVE